REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Mars 2016

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

Prill

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

## Mars 2016

© Ministria e Financave, 2016
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë
www.financa.gov.al
E-mail: marsed.harizi@financa.gov.al
eva.doda@financa.gov.al

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** ____ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** ____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit ____ **3**
2. Kursi Mesatar i Këmbimit ____ **4**
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave ____ **5**
4. Bilanci i Pagesave ____ **6**
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar ____ **7**
6. Kredia për Ekonominë ____ **8**
7. Oferta e Parasë ____ **9**
8. Depozitat sipas Burimeve ____ **10**

**SEKTORI FISKAL** ____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar ____ **11**
2. Të Ardhurat sipas Burimeve ____ **12**

**ANEKSI STATISTIKOR** ____ **13**

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin mars 2016 arriti në 102.47 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin mars 2016 ishte 0.3 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin mars 2016 ishte 124.56lekë për dollarë dhe 138.22 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit mars 2016 shënuan kuotat 1.07 për qind për ato 12-mujore, 0.78 për qind për 6-mujoret ,0.39 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.49 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.47 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.28 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,206,952.5 milionë lekë në muajin mars, duke shënuar një rritje prej rreth 1.4 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm pagesave* për tremujorin e katërt të 2015-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), pra suficit, me rreth 169 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-mars 2016 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 10.3 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 9.2 miliardë lekë) më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që suficiti ishte planifikuar 1.1 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-mars 2016, arritën në rreth 96.7 miliardë lekë ose afërsisht 102.4 për qind e planit për periudhën tremujore.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 83.3 miliardë lekë ose 89.4 për qind e shpenzimeve të planifikuara për periudhën janar-mars.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin mars 2016 ishte +0.3 %. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 2.2%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin mars 2016 shënoi rritje prej 0.5 për qind krahasuar me muajin shkurt 2016. Ky indeks ka shënuar rritje prej 1.1 dhe 0.9 për qind edhe gjatë muajit shkurt dhe janar 2016 krahasuar me muajin paraardhës. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë, kanë shënuar rritje me 0.4 për qind për muajin mars 2015, rritje me 2.4 për qind për muajin shkurt dhe rritje me 1.4 për qind për muajin janar të vitit 2015.

Fig-1




*Ndryshimet mujore të IÇK-së*

Burimi: INSTAT

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishin: "Transport" me një rritje vjetore të çmimit prej -4.5%, duke kontribuar me -0.28 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +0.3%, "Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji" me një rritje vjetore të çmimit prej -0.9% dhe "Veshje dhe këpucë" me një rritje vjetore të çmimit prej -2.3%. Rritja më të madhe gjatë muajit mars u konstatua në kategorinë "Ushqime dhe pije jo alkoolike" me një rritje vjetore të çmimit prej +2.2%, duke kontribuar me +0.81 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +0.3%, "Shërbimi arsimor" me një rritje vjetore të çmimit prej +4.8% si dhe "Pije alkoolike dhe duhan" me një rritje vjetore të çmimit prej +2.6%.

Ndryshimi mujor i indeksit është 0.4 %. Krahasuar me muajin shkurt 2016, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin "Ushqime dhe pije alkoolike" me 1.1 %. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin " Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0.3 %.

Tab - 1 *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

| *VITI* | Janar | Shkurt | **Mars** | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***2015*** | 1.3 | 2.3 | 2.2 | 2.3 | 1.8 | 1.4 | 1.3 | 1.9 | 2.2 | 2.1 | 2.1 | 2.0 |
| ***2016*** | 1.5 | 0.2 | **0.3** | | | | | | | | | |

*Burimi: INSTAT*

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin mars 2016, arriti në 138.22 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me -0.1 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit mars, një euro u këmbye me 138.77 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin mars 2016 arriti në 124.56 lekë/dollarë duke shënuar rënie me -0.1 për qind kundrejt muajit shkurt 2016. Në fund të muajit mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 122.26 lekë/dollarë.

Fig-2




*Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit mars 2016*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në krahasim me muajin mars të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën -3.9 për qind, ndërsa kundrejt monedhës evropiane rezulton se është nënçmuar në masën -1.56 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës amerikane dhe evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatar rreth 0.901 dollarë/euro duke ruajtur të njëjtin nivel të muajit të mëparshëm. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë,etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit mars 2016, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 1.07 dhe 0.78 për qind duke shënuar respektivisht rënie prej -0.08 dhe rritje me 0.04 pikë përqindje krahasuar me muajin shkurt 2016. Rënie për këtë muaj kanë shënuar edhe normat e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujore dhe 1- mujore duke arritur respektivisht në nivelin 0.39 dhe 0.49.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej -0.93 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1- mujor që kanë arritur nivelin 0.49 për qind për mars 2016.

Fig. 3




***Normat e interesit për depozitat (%)***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit mars 2016 shënoi rënie me 0.16 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 7.47 për qind krahasuar me muajin shkurt 2016. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi gjithashtu rënie me 0.20 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 9.28 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit mars 2016, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 1.63 dhe 1.26 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie në *yield*-in e këtyre bonove të thesarit përkatësisht me -0.15 dhe -0.10 pikë përqindje.

Fig-4




***Normat e interesit për huatë dhe bonot***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2015 shënoi rritje të mjeteve valutore, pra suficit, me rreth 169 milionë euro. Tremujori i fundit i 2015-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej 413 milionë euro, me një rritje prej 8% kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2014. Në krahasim me një vit më parë, deficiti i tregtisë së mallrave u rrit me 7% duke arritur në 705 milionë euro. Flukset e kapitalit, shuma e tepricave nën zërin "Llogaria kapitale" dhe "Llogaria financiare", regjistruan një pozicion neto pozitiv prej rreth 493 milionë euro dhe kanë mundësuar plotësisht financimin e deficitit korrent. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Fig-5




***Bilanci i Pagesave per T4-2015***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Llogaria korrente për tremujorin e katërt të vitit 2015 thelloi deficitin e saj në rreth 1,155 milionë euro nga 1287.1 milionë euro që rezultonte në vitin 2014. Ky efekt negativ i llogarisë korente në balancin e pagesave është kompesuar nga përmirësimi i vazhdueshëm i llogarisë financiare dhe kapitale, e cila regjistroi një rritje me 32.4% për tremujorin e katër 2015, kundrejt tremujorit të katërt 2014. Kompozicioni i llogarisë korrente prej -413.7 milionë euro është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2015:

- *(i)* bilanci tregtar me -705.4 milionë euro,
- *(ii)* shërbime neto me 141.2 milionë euro,
- *(iii)* të ardhura neto me 50.3 milionë euro,
- *(iv)* transferta neto me 201.0 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

Fig-6




***Llogaria Korrente per T4-2015***

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit mars 2016, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 55,578.6 miliardë lekë krahasuar me muajin mars të vitit 2015. Kjo rritje ka ardhur më së shumti si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 34,981.6 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 20,597.0 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,206,952.5 milionë lekë në muajin mars, duke shënuar rritje prej rreth 1.4 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin mars 2016, sistemi bankar rezulton me një rënie prej -6,586.2 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin shkurt 2015. Rënia për këtë muaj, krahasuar me muajin paraardhës ka ardhur kryesisht si pasojë e rënies mujore së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me -8,360.5 miliardë lekë.

Fig-7




*Ecuria e M.V.N. të sistemit në Mars '15 - Mars '16*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-8




*Agregati M3 Mars '15 - Mars '16*

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin mars 2016 arriti në 547,076.3 miliardë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin mars 2015 shënoi rënie me vlerë -10,326.1 miliardë lekë, pra rënie prej rreth -1.85 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 55.7për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 304,977 milionë lekë.

Fig-9




***Rritja e stokut total të kredive***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit mars 2016, zëri “Koorporata jo-financiare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 64.9 për qind ose 354,889 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 28.3 për qind ose 154,842 milionë lekë. Zërat “Koorporata jofinanciare publike” dhe “Koorporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.01 dhe 1.65 për qind apo 27,433 dhe 9,040 milionë lekë.

Fig-10




***Përberja e kredive Mars '16***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin mars 2015, zëri “Koorporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 53.64 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 34.93 për qind. “Koorporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.78 për qind dhe rreth 23.04 për qind.

# 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin mars 2016 shënoi rënie me 0.05 për qind krahasuar me muajin paraardhës shkurt 2016. Kjo ofertë arriti në rreth 223,469.7 milionë lekë në fund të muajit mars 2016, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin mars 2015 prej 0.34 për qind.

Fig-11




*Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat*

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin mars 2016, kanë pësuar rënie prej -14,300.4 milionë lekë në krahasim me muajin mars 2015. Depozitat në valutë gjatë muajit mars 2016 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 84.4 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 86.8 për qind të tyre.

Fig-12




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit mars 2016, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 86.8 për qind, ndjekur nga “Koorporata të tjera jofinanciare”, me rreth 10.0 për qind dhe nga “Koorporata jofinanciare publike”, me 1.9 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Koorporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 84.4 për qind dhe rreth 13.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 85.6 për qind e totalit.

Fig-13




***Rritja e stokut total të depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 841,765.1 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Koorporata të tjera jo financiare” (115,628.9 milionë lekë), “Koorporata jo financiare publike” (14,397.1 milionë lekë) dhe “Koorporata të tjera financiare” (9,877.9 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,813.9 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit mars 2016, niveli i përgjithshëm i depozitave krahasuar me një muaj më parë, shënoi rritje prej 1,011.8 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 9,125 milionë lekë.

Fig-14




***Përberja e depozitave Mars 2016***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Fig - 15




***Treguesit Fiskal, shkurt 2016***

Burimi: Ministria e Financave

Për periudhën janar-mars 2016 janë mbledhur rreth 96.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 83.3 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 75.3 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 8 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 51% janë financime të jashtme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 66.6 miliardë lekë (ose rreth 103.2% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 2.2 miliardë lekë (ose rreth 48% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 19.4 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 6 miliardë lekë (ose rreth 118.5% e planit për periudhën janar-mars).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 75.3 miliardë lekë, 16.5 miliardë lekë (22% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 9.3 miliardë lekë (12.3%) për interesat, 6.5 miliardë lekë (8.7%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 273 milionë lekë (0.4%) për subvencione, 32.9 miliardë lekë (44%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 5.7 miliardë lekë (7.6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 4.2 milirdë lekë (5.6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 23% (shpenzime personeli), 22% (shpenzime për interesat), 15% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 16% (subvencione), 22% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 12% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 18% shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 13%, ndërsa financimi i huaj është 14% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-mars 2016 ishin rreth 96.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 88.2 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 6 miliardë lekë.

**Tab - 2** ***Të ardhurat gjatë periudhës janar-mars 2016 (mld Lekë)***
***Revenues during January-March 2016 (in billion ALL)***

| Burimi (Source) | mar'16<br>Mar'16 | mar'15<br>March'15 | Ndrysh(%)<br>Chang (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH (VAT) | 30.0 | 27.0 | 11.1 |
| Tatimi mbi fitimin (Profit Tax) | 10.8 | 8.9 | 21.3 |
| Taksa doganore (Custom Tax) | 1.3 | 1.27 | 2.4 |
| Taksat nacionale (National Tax) | 8.0 | 6.1 | 31.1 |
| Akcizat (Excise) | 8.6 | 7.1 | 21.1 |
| Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax) | 8.0 | 6.1 | 31.1 |

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: mars – 2016;*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: March – 2016;*

## 1. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 13.4 miliardë lekë, përgjatë periudhës janar-mars 2016, u mbështet kryesisht nga huamarrja e jashtme (rreth 66% të totalit të deficitit) dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj (rreth 24% të totalit të deficitit).

Për muajin mars 2016, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 34,928 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 31,856 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin mars 2016, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 32.4 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 26.8 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.1 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| Muaji | Mujor (Monthly) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | **2016** | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | **2016** | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | **2016** | Month |
| Janar | 0.8 | 0.7 | 1.0 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | 0.80 | 0.7 | 1.00 | 0.8 | 1.4 | 0.9 | 3.3 | 1.6 | 2.7 | 1.7 | 1.3 | 1.5 | January |
| Shkurt | 2.3 | 1.3 | 1.1 | 1.4 | 2.4 | 1.1 | 1.55 | 1.0 | 1.05 | 1.1 | 1.9 | 1.0 | 4.5 | 0.6 | 2.5 | 1.9 | 2.3 | 0.2 | February |
| **Mars** | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.5 | 0.4 | **0.5** | 1.00 | 0.8 | 0.77 | 0.9 | 1.4 | **0.7** | 4.3 | 1.0 | 2.4 | 2.2 | 2.2 | **0.3** | **March** |
| Prill | -0.6 | -0.1 | -0.1 | -0.6 | -0.5 | | 0.60 | 0.6 | 0.55 | 0.5 | 0.9 | | 4.1 | 1.6 | 2.3 | 1.7 | 2.3 | | April |
| Maj | -1.1 | -0.8 | -1.0 | -1.1 | -1.6 | | 0.26 | 0.3 | 0.24 | 0.2 | 0.5 | | 4.2 | 1.9 | 2.1 | 1.6 | 1.8 | | May |
| Qershor | -1.1 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | -1.1 | | 0.04 | 0.1 | 0.15 | 0.1 | 0.1 | | 3.9 | 2.2 | 2.3 | 1.5 | 1.4 | | June |
| Korrik | -0.7 | -0.2 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | | -0.07 | 0.1 | -0.03 | 0.0 | 0.3 | | 3.6 | 2.7 | 1.6 | 1.8 | 1.3 | | July |
| Gusht | 0.3 | 0.4 | -0.1 | 0.1 | 0.8 | | -0.02 | 0.1 | -0.04 | 0.0 | 0.1 | | 3.1 | 2.8 | 1.2 | 2.0 | 1.9 | | August |
| Shtator | 0.4 | 0.2 | 0.8 | 0.3 | 0.6 | | 0.02 | 0.1 | 0.06 | 0.0 | 0.2 | | 2.8 | 2.6 | 1.7 | 1.5 | 2.2 | | September |
| Tetor | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.1 | 0.01 | | 0.06 | 0.1 | 0.05 | 0.0 | 0.3 | | 3.0 | 2.4 | 1.7 | 1.4 | 2.1 | | October |
| Nëntor | 0.1 | 0.2 | -0.5 | -0.2 | -0.3 | | 0.06 | 0.1 | 0.01 | 0.0 | 0.1 | | 2.9 | 2.5 | 1.0 | 1.7 | 2.1 | | November |
| Dhjetor | 1.0 | 0.9 | 1.7 | 0.7 | 0.6 | | 0.14 | 0.2 | 0.15 | 0.1 | 0.17 | | 1.7 | 2.4 | 1.9 | 0.7 | 2.0 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë*

*Source : INSTAT,Bank of Albania*

**Tab - 2** **Kursi i këmbimit**

Exchange rate

| Monedha | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 Janar | 2016 Shkurt | 2016 **Mars** | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 100.90 | 108.18 | 105.67 | 113.64 | 126.64 | 127.37 | 124.70 | 124.56 | USD |
| EURO | 140.33 | 139.04 | 140.27 | 140.11 | 137.65 | 138.35 | 138.33 | 138.22 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 107.54 | 105.85 | 101.86 | 115.23 | 125.79 | 127.06 | 126.59 | 122.26 | USD |
| EURO | 138.93 | 139.59 | 140.20 | 140.14 | 137.28 | 138.68 | 138.24 | 138.77 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

**Tab - 3** **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**

Annual Interest Rates (in ALL)

| Në përqindje | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 Janar Jan | 2016 Shkurt Feb | 2016 **Mars Mar** | In percent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | Deposits rates |
| 12-M | 5.87 | 5.38 | 4.17 | 1.51 | 1.27 | 1.18 | 1.15 | 1.07 | 12-M |
| 6-M | 4.87 | 4.50 | 3.40 | 1.16 | 1.17 | 0.90 | 0.74 | 0.78 | 6-M |
| 3-M | 4.22 | 3.83 | 2.72 | 0.83 | 0.54 | 0.50 | 0.51 | 0.39 | 3-M |
| 1-M | 4.39 | 3.62 | 2.79 | 1.47 | 0.88 | 1.14 | 0.56 | 0.49 | 1-M |
| **Norma e huasë** | | | | | | | | | Lending rates |
| 12-M | 11.17 | 10.28 | 9.52 | 7.00 | 7.47 | 8.29 | 7.31 | 7.47 | 12-M |
| 6-M | 12.28 | 10.61 | 9.59 | 8.18 | 8.35 | 9.24 | 9.48 | 9.28 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlerë** | | | | | | | | | Securities rates |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 5.31 | 5.03 | 3.40 | 3.15 | - | 1.45 | - | - | 3-M |
| 6-M | 6.23 | 5.65 | 3.54 | 3.16 | 2.46 | 1.99 | 1.36 | 1.26 | 6-M |
| 12-M | 6.95 | 6.37 | 3.66 | 3.33 | 2.40 | 2.10 | 1.78 | 1.63 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

**Tab - 4** **TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2016**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2016

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë (in million ALL)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | Janar<br>January | Shkurt<br>February | Mars<br>March | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **32,577** | **61,736** | **96,664** | **TOTAL REVENUE** |
| **I.** | **Të ardhura nga ndihmat** | **335** | **1,655** | **2,542** | **Grands** |
| **II.** | **Të ardhura tatimore** | **29,540** | **55,722** | **88,161** | **Tax Revenue** |
| **II.1** | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **21,121** | **40,946** | **66,561** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 10,091 | 19,840 | 29,909 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,477 | 3,439 | 10,788 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 2,789 | 5,561 | 8,588 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 3,295 | 5,752 | 7,969 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 3,071 | 5,546 | 8,000 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 398 | 808 | 1,307 | Customs Duties |
| **II.2** | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **643** | **1,202** | **2,217** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 193 | 351 | 650 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 74 | 170 | 431 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 376 | 681 | 1,136 | Local Taxes |
| **II.3** | **Të ardh nga fondet speciale** | **7,776** | **13,574** | **19,383** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 7,045 | 10,778 | 15,724 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 625 | 2,480 | 3,142 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 106 | 316 | 517 | Revenues for property compesation |
| **III.** | **Të ardhura Jotatimore** | **2,702** | **4,359** | **5,961** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 0 | | 0 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 2,015 | 3,132 | 4,255 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Dividenti | 0 | 2 | 2 | Divident |
| 4 | Tarifat shërbimeve | 513 | 653 | 788 | Tariffs on servises |
| 5 | Të tjera | 174 | 572 | 916 | Other/not allocated |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **23,710** | **51,424** | **83,280** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| **I.** | **Shpenzime Korrente** | **22,489** | **48,531** | **75,314** | **Current Expenditures** |
| **I.1** | **Personeli** | **5,430** | **10,918** | **16,463** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 4,657 | 9,376 | 14,148 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 773 | 1,542 | 2,315 | Social insurance contributions |
| **I.2** | **Interesat** | **3,305** | **6,576** | **9,282** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 2,481 | 5,105 | 7,338 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 824 | 1,471 | 1,944 | Foreign |
| **I.3** | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,204** | **3,752** | **6,528** | **Operational & Maintenance** |
| **I.4** | **Subvecionet** | **54** | **100** | **273** | **Subsidies** |
| **I.6** | **Shpenzime për fonde speciale** | **10,263** | **21,510** | **32,856** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 8,332 | 16,643 | 25,362 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 1,931 | 4,669 | 7,296 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit te pronareve | 0 | 198 | 198 | Expenditures for Owners Compensation |
| **I.7** | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **1,399** | **3,365** | **5,730** | **Local budget expenditure** |
| **I.8** | **Shpenzime të tjera** | **834** | **2,310** | **4,182** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | 41 | 85 | 133 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 801 | 1,956 | 3,782 | Social assistance |
| 5 | Kompensimi i ish-të përndjekurve politike | -8 | 269 | 267 | Compansation for ex-political prisioners |
| **III** | **Shpenzime Kapitale** | **1,221** | **2,893** | **7,966** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 46 | 474 | 4,020 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 1,175 | 2,419 | 3,946 | Foreign financed |
| **V.** | **DEFICITI** | **8,867** | **10,312** | **13,384** | **CASH BALANCE** |
| **V.1** | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-8,867** | **-10,312** | **-13,384** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| **V.2** | **Brendshëm** | **-8,903** | **-19,537** | **-22,178** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 204 | 207 | 358 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | 2,503 | 3,818 | 5,249 | Domestic new borrowing (net) |
| 2.1 | Nacionale | 2,513 | 3,835 | 5,273 | Other |
| 2.2 | Lokale | -10 | -16 | -24 | Foreign |
| 3 | Të tjera | -11,610 | -23,562 | -27,785 | Other |
| 4 | Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë | -499 | -14,410 | -11,935 | Government deposits into the Central Bank |
| 5 | Të tjera | -11,109 | -9,151 | -15,846 | Other |
| 6 | Depozita e ISSH dhe ISKSH | -2,759 | -1,391 | -4,083 | Deposits of Socila and Health insurance |
| 7 | Mjete në ruajtje | 69 | -79 | -245 | Preservation stock |
| 8 | Nënhua | 94 | 160 | 269 | On-Loan Principal |
| 9 | Detyrim ndaj ISSH | 621 | 1,652 | -386 | Liabilities to SSI |
| 10 | Të tjera (detyrime të përkohshme) | -7 | 28 | 14 | Other-Float |
| **V.3** | **I huaj** | **36** | **9,225** | **8,794** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 4,002 | 2,794 | 3,618 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Nga e cila nënhua | 242 | 418 | 857 | Subsidiary Loan |
| 3 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | -3,161 | -2,027 | -1,990 | Chang. of stat. Account |
| 4 | Ripagesat | -805 | -1,584 | -2,876 | Repayments |
| 5 | Mbështetje Buxhetore | 0 | 10042 | 10042 | Budgetary Support |

*Burimi : Ministria e Financave* *Source : Ministry of Finance*

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2016**

Table of investments 2016

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million ALL)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>Feb | Mars<br>Mar | |
|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **46** | **474** | **4,020** | **Domestic financing** |
| *Në %* | *3.77* | *16.38* | *50.46* | *In %* |
